



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 20/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Sh.M, për shkak të anulimit të vendimit nr. V\_1045\_2018 të datës 24.09.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 12.09.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 26.09.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., (KES/CO), me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit nr. V\_1045\_2018 të datës 24.09.2018 të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

A r s y e t i m

Paditësi Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A. (KES/CO), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) nr. V\_1045\_2018 të datës 24.09.2018 si jo i ligjshëm, me arsyetimin se fatura për muajin prill 2016 është në rregull bazuar në raportin e shqyrtimit në qendrën e kalibrimin i cili ka theksuar se njehsori elektrik nuk ka qenë në rregull, ka pasur vulat shtetërore, tarifa e parë dhe e dytë kanë qenë në rregull, nga ana e jashtme nuk ka pasur dëmtime si dhe kanë konstatuar se gabimi në matje është -1.65%, andaj paditësi pretendon se arsyetimi i të paditurës se konsumatori ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në periudhën 04/2016 në njehsorin kontestues nuk mund të merret si i saktë, pasi që nëse marrim shpenzimin mesatar për muaj në periudhën 12/2015 deri 04/2016 është 1,728 kWh e që është i përafërt me shpenzimin mesatar mujor në periudhën 06/2015 deri 10/2015. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare gjykatës i ka propozuar që të

aprovohet padia e paditësit KES/CO ashtu që të shfuqizohet në tërësi vendimi i të paditurës ZRRE si i pabazuar.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i Bordit të ZRRE-së është nxjerrë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë si dhe të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Gjithashtu ka theksuar se gjatë shqyrtimit dhe trajtimit të lëndëve të konsumatorëve, nuk mund të merret për bazë një provë e vetme, respektivisht raporti nga Qendra e Kalibrimit, por që në bashkëlidhje me njëra tjetrën duhet të vlerësohen të gjitha provat. Tutje kanë theksuar se faturimit prej 6,272 kWh për periudhën 04/2016 nuk është shpenzim real pasi që në asnjë periudhë tjetër nuk kemi shpenzim të ngjashëm të konsumatorit. Në seancën e shqyrtimit kryesor kanë theksuar se paditësi nuk ka evidentuar asnjë çrregullim në matje të njehsori elektrik në periudhat e mëhershme pasi që nga analiza e rrejdhës së energjisë elektrike e paditura ka gjetur se konsumatori ka rritje të pashpjegueshme të energjisë elektrike vetëm në periudhën prill 2016, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadija e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i bordit të ZRRE.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim i të paditurit nr. V\_1045\_2018 i datës 24.09.2018, Vendim i të paditurit V\_1841\_08\_18 i datës 07.08.2018, Transaksionet për konsumatorin për periudhën 20.12.2005 deri me 12.10.2018, Rrjedha e njehsorit të energjisë aktive për periudhën 12.2005 deri 10.2018, Procesverbal nr. 0634827 i datës 26.04.2016, Protokoll i shqyrtimit të njehsorit elektrik në qendrën e kalibrimit nr. 02-14702, dt. 20.09.2016, Procesverbal i datës 11.05.2016, Formular i ankesës së konsumatorit.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thëniet në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurës si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

Me Vendimin e Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve (DMK-së) ZRRE/DMK\_V\_1841\_08/18 të datës 07.08.2018, është aprovuar ankesa e konsumatorit I.G nga komuna Ferizaj, dhe është obliguar KES/CO që konsumatorit me shifër DFE-9017480, t'ia anulojë faturat 0416316DFE-9017480 dhe nr. 0416416DFE-9017480 të datës 11.04.2016, si dhe korigjimi nr. 43623DFE-9017480 të datës 28.09.2016 si dhe është obliguar KES/CO që konsumatorin me shifër DFE-9017480 për periudhën 04/2016 ta faturoj

me shpenzimet e regjistruara në periudhën 04/2017 me njehsorin elektrik nr. 30515134 ku TL=521 kWh dhe TU=102 kWh.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin, ka ushtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, të cilët me Vendimin V\_1045\_2018 të datës 24.09.2018 kanë refuzuar si të pabazuar ankesën e KES/CO ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin me shifër të konsumatorit DFE-9017480 dhe ka mbetur në fuqi vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_1841\_08\_18 i datës 07.08.2018.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 15 par. 1, nën-par. 1.8 dhe 1.9 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë të cilët përcaktojnë: *“1. Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: ... 1.8. të sigurojë mbrojtjen e konsumatorëve dhe të licencuarve me rregulla adekuate për zgjidhje të kontesteve; 1.9. të sigurojë se interesat në mes konsumatorëve dhe ndërmarrjeve të energjisë balancohen në mënyrë adekuate dhe se mbrohen konsumatorët në nevojë;”* si dhe në kuptim të nenit 17 par. 1 që përcakton se: *“1. Rregullatori harton procedura për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, përfshirë ankesat: 1.1. nga konsumatorët kundër të licencuarve, në lidhje me shërbimet e ofruara;”*. Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 14, 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë (Rregulla ZRRE/Nr. 04/2017 e datës 16 mars 2017) që përcaktojnë kompetencën e DMK-së pranë ZRRE për trajtimin e ankesave të konsumatorëve ndaj vendimeve që merren nga furnizuesi apo operatori i sistemit si dhe kompetencën e Bordit të ZRRE-së për vendosjen për ankesat ose kontestet ndaj vendimeve të DMK-së.

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara. Gjykata nga prova Formular i ankesës së konsumatorit, ka konstatuar se konsumatori I.G me datë 14.04.2016 ka paraqitur tek paditësi ankesë për shumën e lartë të faturës për muajin prill 2016. Nga prova Procesverbal i datës 11.05.2016, gjykata ka konstatuar se paditësi ka bërë evidentimin e shpenzimeve deri me datë 11.05.2016 me njehsorin e ri, përkatësisht TL=358 kWh dhe TU=113 kWh. Nga prova Protokoll i shqyrtimit të njehsorit elektrik në qendrën e kalibrimit nr. 02-14702, dt. 20.09.2016 gjykata ka gjetur se paditësi ka konstatuar se njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik ka vulat (bllombat) shtetërore, tarifa e parë dhe tarifa e dytë është në rregull, nga ana e jashtme njehsori dëmtime nuk ka si dhe kanë konstatuar se ka pasur gabime në matje prej -1.65% në të dy tarifat. Nga prova Rrjedha e njehsorit të energjisë aktive dhe Transaksionet e konsumatorit gjykata konstatoi se konsumatori për periudhën prill 2016 është faturuar për shpenzime të energjisë 6,272 kWh, ndërsa për periudhën e njëjtë për tre vitet

paraprake ka shpenzuar si në vijim: prill 2015: 770 kWh; prill 2014: 680 kWh; prill 2013: 247 kWh, ndërsa për periudhën e njëjtë për dy vitet e ardhshme ka shpenzuar si në vijim: prill 2017: 623 kWh dhe prill 2018: 888 kWh.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me konstatimin e DMK-së se shpenzimi i faturuar nga KES/CO për periudhën prill 2016 prej 6,272 kWh nuk ka qenë i saktë, pasi që në asnjë muaj tjetër as për së afërmi nuk ka pasur shpenzim të ngjashëm nga konsumatori. Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë arsyetimin e ZRRE se nga analiza rreth krahasimit të shpenzimeve të energjisë elektrike për periudhën kontestuese me periudhat e njëjta të mëhershme dhe të më vonshme, ka ndryshim në shpenzimin e energjisë elektrike vetëm në periudhën prill 2016.

Gjykata vlerëson se një faturim i tillë nga paditësi është në kundërshtim me Rregullën për Kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji (Rregulla ZRRE/Nr. 12/2017, 13 prill 2017) në nenin 5 par. 1, pika 1.5 që përcakton se: *“1. Në përputhje me dispozitat e kësaj rregulle, të gjithë konsumatorët kanë të drejtën dhe obligimin që të: 1.5. paguajnë për energjinë e shfrytëzuar, sipas kontratës për Furnizim me Energji të lidhur me Furnizuesin e Energjisë, si dhe për tarifën për shfrytëzim të sistemit të miratuar nga ZRRE-ja;”* dhe në pikën 1.6. përcakton se: *“marrin kompensim nga furnizuesi, për energjinë e pa-dërguar ose për furnizim me energji të cilësisë së dobët dhe shërbim , që nuk është në përputhje me kontratën për furnizim me energji dhe standardet e furnizimit dhe shërbimit që iu ofrohen konsumatorëve.”* Gjithashtu në nenin 28 par. 1 dhe 3 përcaktohet se: *“1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe për tarifën tjera, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme). ... 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktojnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Vendimit të DMK-së me të cilin është vendosur që konsumatori me shifër DFE-9017480 të faturohet me shpenzimet prej TL=521 kWh dhe TU=102 kWh, ndërsa të anulojë faturat 0416316DFE-9017480 dhe nr. 0416416DFE-9017480 të datës 11.04.2016, si dhe korrigjimi nr. 43623DFE-9017480 të datës 28.09.2016.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera të administruara në këtë çështje, por vlerësoi se të njëjtat nuk ishin relevante me çështjen dhe me ndikim për vendosje ndryshe.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit të dhëna në seancën gjyqësore por vlerësoi se krahasimi i shpenzimeve me periudha të ndryshme gjatë vitit nuk mund të jetë krahasim i saktë për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike, për shkak se periudha mars 2015 deri tetor 2015 të cilën paditësi e ka marrë si bazë të krahasimit të shpenzimeve është periudha kur konsumatori ka shpenzuar më së shumti energji elektrike, pra nuk mund të shërbejë si shpenzim krahasues me periudhën dhjetor 2015 deri prill 2016.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.20/22, datë 26.09.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.